

RËNDËSIA E PARANDALIMIT PRIMORDIAL DHE PRIMAR NË SHFAQJEN E FRUTHIT TEK FËMIJËT



Petrit Delija

Doktor i Mjekësisë

Hyrje

Fruthi, ndryshe i njohur edhe si morbilli, është një sëmundje infektive virale që shkaktohet nga virusi i fruthit. Përkundër vaksinimit të obligueshëm në pothuajse të gjitha vendet e botës, fruthi është ende përgjegjës për më shumë se 100,000 vdekje çdo vit. Për dallim nga më shumë se 2 milionë vdekje në vit përpara përdorimit të gjerë të vaksinës së fruthit. [1] Parandalimi primordial konsiston në zvogëlimin e faktorëve të rrezikut përpara se ata të shfaqen në popullatë duke u fokusuar veçanërisht në edukim dhe promovim shëndetësor. Politikat vendore e ndërkombëtare së bashku me ligjet përkatëse janë përgjegjëse në përpilimin e masave të tilla. Si modaliteti më i hershëm i parandalimit, synohet që fëmijët të zvogëlojnë në minimum ekspozimin ndaj rrezikut. Kurse parandalimi primar konsiston në masat si vaksinimi. Ku qëllimi kryesor i vaksinimit është të kufizojë mundësinë e shfaqjes së një sëmundjeje (fruthit në këtë rast). Pra popullata e targetuar e parandalimit primar janë individë të shëndetshëm, por që janë të rrezikuar për të fituar një sëmundje. [2]

Metodologjia

Ky punim është rishikim i literaturës shkencore. Informatat e grumbulluara janë shqyrtuar nga burime të besueshme të të dhënave shkencore, të publikuara kryesisht në periudhën 2008-2024. Kërkimi i literaturës është bërë në databaza të njohura si: PubMed, Cochrane Library dhe faqja zyrtare e OBSH. Literatura nga gjuha shqipe është përfshirë dhe është marrë parasysh vetëm ajo në gjuhën angleze me qëllim të saktësisë së informatave. Të dhënat janë sistematizuar dhe analizuar në mënyrë përmbledhëse për të nxjerrë përfundime të përgjithshme mbi rëndësinë e parandalimit primordial dhe primar dhe problemet kryesore në implementimin e tyre në nivele të ndryshme shoqërore dhe gjeografike.

Rezultatet

Gjasat e prekjës nga fruthi ulen rreth 95% pas administrimit të një doze të vaksinës MMR (vaksina e kombinuar kundër fruthit, shytave dhe rubeolës). Kjo do të thotë se ulët mundësia për tu infektuar me fruth tek personat e vaksinuar përafërsisht 20 herë. Pas dy dozave të vaksinës MMR, ulët mundësia e infektimit me fruth rreth 25 herë, në raport me fëmijët që nuk janë vaksinuar. Mbrojtja të disa fëmijë arrihet vetëm përmes dy dozave. Vaksina gjithashtu ndihmon në parandalimin e përhapjes së fruthit si në familje dhe brenda në komunitet. [3] Në periudhë prej më shumë se dy dekadash, diku rreth 23 vite, Organizata Botërore e Shëndetësisë së bashku me organizata të tjera parandaluan diku rreth 60 milion vdekje nga fruthi. Krejt kjo e arritur përmes një vaksinimi të rregullt. [4] Një studim ka treguar se vende me nivel më të lartë

të të ardhurave, urbanizim më të theksuar dhe stabilitet politik më të mirë, kanë më pak raste me fruth, gjë që tregon se mirëqenia sociale dhe infrastruktura e zhvilluar shëndetësore luajnë rol kyç në parandalimin e kësaj sëmundjeje. Sipas kësaj analize është vërejtur që hezitimi ndaj vaksinave mund të jetë një faktor i rëndësishëm kontribuues në rritjen e fundit të incidencës së fruthit në vendet më të pasura. Për shembull, rastet e reja të fruthit të shfaqura në kontinentin e Evropës dhe Amerikës kanë qenë të ndërlidhura me udhëtimet ndërkombëtare dhe komunitetet ku dominonte dyshimi mbi efektivitetin e vaksinave. [5] Një hulumtim i realizuar në Brazil zbuloi se mosha, vendbanimi, gjendja martesore dhe arsimi nuk kishin ndikim të dukshëm në mënyrën se si individët vaksinohen kundër fruthit. Ndërkohë, shumica e të anketuarve pranuan se, pavarësisht njohurive që kishin për fruthin dhe vaksinën, nuk e kishin marrë vaksinën në përputhje me afatet e rekomanduara nga institucionet shëndetësore. Rezultatet treguan se prindërit e shtynë vaksinimin me arsyetimin që ndjenin dhembshuri për fëmijët e tyre. Si rrjedhojë shumica nuk e morën vaksinën kundër fruthit në datën e rekomanduar saktësisht, por vonuan. [6] Sipas një hulumtimi të bërë në vendin tonë, i cili përfshinte mbi 400 fëmijë, pjesa dominuese e tyre rreth 90% kishin përfunduar kalendarin e plotë të imunizimit. Edhe pse shumica e vaksinimeve nuk ishin bërë në kohën e duhur dhe vonesat ishin nga 1 muaj, të ndjekura nga vonesa deri në 3 muaj. Ku si arsyeja dominuese ishte Pandemia e COVID-19, e ndjekur nga sëmundjet shoqëruese të fëmijëve në kohën kur fëmija duhej vaksinuar ose ekzistonte edhe arsyetimi që prindërit kishin obligime të tjera dhe si rrjedhojë nuk mund ta dërgonin fëmijën për tu vaksinuar. [7]

Diskutimi

Arsyet për refuzimin për të vaksinuar fëmijët janë të lehta për t'u identifikuar: ata që kundërshtojnë vaksinimin bazohen në supozimin se fruthi është një sëmundje e padëmshme e fëmijërisë dhe gjithashtu ia atribuojnë atë me gjasat që mund të ndikojnë në zhvillimin e një fëmije. Shqetësimi kryesor i skeptikëve në lidhje me sigurinë e vaksinimit, lidhet me efektet e mundshme negative afatgjata. Frika për ekspozimin e një fëmije të shëndetshëm ndaj mundësive të shfaqjes së efekteve negative të vaksinimit është e pranueshme dhe njihet në shkencat e sjelljes si i ashtuquajti paragjykimi i lëshimit. Uebfaqet e ndryshme në internet që janë jo serioze stimulojnë frikën në popullatë me informacione që pothuajse gjithmonë janë të pavërteta. [8]

Përfundime:

Efektiviteti i vaksinës MMR është shumë i lartë diku rreth 95% me një dozë të vaksinës. Edhe

RËNDËSIA E PARANDALIMIT PRIMORDIAL DHE PRIMAR NË SHFAQJEN E FRUTHIT TEK FËMIJËT



Haxhi Kamberi


Specialist i Pediatriës

pse marrja e dy dozave e rrit mbrojtjen imunitare dhe si rrjedhojë ul shanset për infektim me mbi 25 herë. Rëndësia e vaksinimit individual theksohet atëherë kur edhe familja edhe komunitetit mbrohen nga ky vaksinim i shumicës së individëve. Fushatat globale të fokusuara në promovim shëndetësor mbi fruthin kanë shpëtuar miliona jetë në shumë vende të botës. Shembull konkret është parandalimi i mbi 55 milionë vdekjeve nga fruthi në periudhën kohore 2000-2023. Faktorët e ndryshëm socio-ekonomik si urbanizimi janë të lidhur me ulje të rasteve me fruth, ndërsa në vendet e zhvilluara dominon dyshimi ndaj vaksinave, sidomos pas pandemisë COVID-19. Në vende si Kosova, ndonëse shumica e fëmijëve janë të vaksinuar, shpesh vaksinat nuk jepen në kohën e rekomanduar për shkak të pandemisë së fundit, sëmundjeve ekzistuese të fëmijës apo arsye të tjera familjare. Të dhëna që tregojnë se vonesat në vaksinim janë të zakonshme. Prindërit shpesh vonojnë vaksinimin për shkak të lidhjes emocionale me fëmijën e tyre dhe frikën që vaksina mund t'i shkaktojë dhimbje ose pasojë fëmijës. Edhe mungesa e njohurive të mjaftueshme mbi rëndësinë e vaksinës, sidomos në vendet me edukim të ulët është mjaft e evidente. Si rrjedhojë vërehet nevoja për edukim dhe ndërgjegjësim më të madh.

Figura 1. Poster informues në lidhje me simptomat e fruthit. (Measles - Disease Surveillance Epidemiology Program - MeCDC; DHHS Maine [Internet]. (www.maine.gov)).

Referencat:

1. Wilson SE, Salvadori MI, Science M. Measles. CMAJ [Internet]. 2024 Apr 22 [cited 2024 Apr 23];196(15):E524-4. Available from: <https://www.cmaj.ca/content/196/15/E524>.
2. Kislign L, Das J. Prevention strategies [Internet]. National Library of Medicine. StatPearls Publishing; 2023. Available from: <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK537222/>.
3. Di Pietrantonj C, Rivetti A, Marchione P, Debalini MG, Demicheli V. Vaccines for measles, mumps, rubella, and varicella in children. Cochrane Database of Systematic Reviews. 2021 Nov 22;2021(11).
4. World Health Organization. Measles [Internet]. World Health Organization. 2024. Available from: <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/measles>.
5. Subekshya Bidari, Yang W. Global Resurgence of Measles in the Vaccination Era and Influencing Factors. International Journal of Infectious Diseases. 2024 Jul 1;147:107189-9.
6. Logullo P, Carvalho HB de, Saconi R, Massad E. Factors affecting compliance with the measles vaccination schedule in a Brazilian city. Sao Paulo Medical Journal. 2008 May;126(3):166-71.



Korrespondenca:
haxhi.kamberi@uni-gjk.org